

Adem Zaplluzha

**Letër
Nga
Mërgimi**

Boton
Shtëpia e Kulturës

Klubi letrar ‘Fahri Fazliu’

Kastriot

Redaktor:

Rexhep Kllokoqi

Recensentë:

Mazllum Baraliu

Hamdi Tasholli

Korrektor:

Bedri Neziri

Ballina:

Ragip Thaçi

Dizajni i ballinës:

Mentor Lutolli

Realizimi kompjuterik:

Admir Krasniqi

Adem Zaplluzha

**Letër
Nga
Mërgimi**

KUKULLA ZËRINA

I kam njëqind kukulla
Këtu në perëndim
Por më e bukura
Është ajo e vendit tim

Kjo është tullace
I ka flokët e gjata
E bukura nga Kosova
Me shumë krajata

Mërzitet për lumin
Për male e kodrina
Kukulla ime e bukur
E quajtura Zërina

MË KËPUTET ZEMRA

Më copëtohet zemra
Ndahet në dysh
Kur i shoh fëmijët
Këtu pa gjysh

Kur lozin e këndojnë
Këngë në gjuhë të huaj
Sa është e bukur Kosova
Mami të lutem më thuaj

Dua të këndojë edhe unë
Këngët e vendit tim
Le të dëgjohet kjo gjuhë e bukur
Këtu në mërgim

MË THUAJ BABI

Babi më fal të lutem
Për pak harrova
O të përgjërojë zemër
Më trego
A është shumë larg
Dhe ku gjendet Kosova

Në cilin det
Derdhen lumenjtë
Në cilat fusha
Perëndon dielli
O zapi im më thuaj
A skuqet si lulja
Atje qielli

A janë vogëlushët
Të gëzuar
Kur shohin ëndrra
Si unë në mërgim
Kosovën e dashur
Dhe të lulëzuar
Më rrëfe babi
Më thuaj shpirti im

KËSHTU KËNDOI NAIMI

Sa bukur tingëllon gjuha shqipe
Kjo e folme e lashtësisë
Kur Adea për çdo ditë
Me nga një sinonim e qëndisë

Kur i shqipëron fjalët
Fjalitë në ogra ja qeshin
Dhe fushat e Kosovës
Një fustan të bukur veshin

Kështu këndoi Naimi
Në këtë gjuhë të perëndisë
Kështu do madhërojë edhe Genti
Rrënjët e Ilirisë

TOKA JONË

Më dhemb këmba
Mu në thembër
Pse lum babi
Më la pa zemër

Zemra ime është Kosova
Me ato të bukura fusha
Kur më kaplon malli shumë
Me një dhembje më ngulfatet gusha

Një lëmsh i pazgjidhur
Më sillet në kokë
Sa herë që ëndërroj
Të bukurën tokë

VENDI BIBLIK

Në stacion
Më zuri gjumi
Gjatë tërë kohës
Unë ëndërrova
Genti o vëllai im
Sa e bukur
Qenka Kosova

Sa i paska
Njerëzit e mirë
Sa të ndershëm
Dhe bujar
Pse lum Babi
Nuk më ke treguar
Për këto dhunti
Edhe më parë

Bijë e dashur
Ti ëndërro
Për atë vend
Kaq fisnik
Dhe kurrë në jetë
Mos harro
Me e dashtë
Atë vend biblik

SI POSTJERJA

Fërfëllojnë harabelat
Nëpër lisa
E nëpër tela
Sjellin letra
E lajme taze
Si postierja
Me dantella

Vjen një letër
Nga veriu
E nga jugu
Arrin tjetra
Shumë të bardha
E pak të zeza
Fati jonë
I pret këto letra

Si nga lindja
E perëndimi
Vijnë lajme vaji
Vijnë shpresa shpëtimi

TUNG KOSOVË

Tung Kosovë
Me shtatë name
Ti që robërinë
Nuk e durove

S'ta pamë lotin
Kur dënese
I qaje burrat
Që u vranë

I qaje lulet
Kur i shkelën
Pa u ndalur ece
Drejt fitores
Sikur trimat
E Mashkullores

ECJA UDHËS

Ecja udhës
I menduar
Ç'kërkojë unë
Në perëndim

Ku janë njerëzit
E vatrës sime
Ku janë burrat
O zot i im

Ku janë lulet
Në luadhe
Ku janë zogjtë
Me sorkadhe

Ecja rrugës
Si kokëtul
Më dukej vetja
Somnambul

Ecja ecja
Nëpër këtë vërrimë
Sado pak
Të gjejë shpirtin tim

KTHIMI

Oh sa qenka
Lumi i bukur
E dredharak
Fluturo sikur flutur
Drejt atdheut
Në Kosovën plakë

I bënë të fala
Lagjes tonë
Ku në prag
Na pretë gjyshja
Se ma ardhjen e pranverës
Këtu kthehet
Dallëndyshja

VETËM GJUHA SHQIPE

Këtu kthehen
Shumë zogj shtegtarë
Që shtegtojnë
Në brigjet e qiellit
Me gjuhë të huaja
Si në Pazar
Por vetë gjuha shqipe
Kjo gjuhë e diellit
Flakërinë
Si lulja e prillit

KËNDONTE SHQIP

Ajo lozte
Mbi një rrap
Cicëronte
Një gjuhë të huaj
Por më shumë
Këndonte shqip
ADEA e vogël
Sy gështenje
Që i kishte
Njëzetë muaj

KËTO KRAJATA

Ku të zë gjumi
Kur vjen nata
Përse të lodhin
Këto krajata

Ç'bëre në jetë
Që ndihesh me faj
Përse sytë
I ke me vajë

Të të mos e lëndojë
Zemrën mërgimi
NËNË Kosova
Është shpëtimi

ME LOT HIDHËRIMI

Kur bie shi
Në Prishtinë
Në Ottavë
Agu gdhinë

Po loton
Pullazi plak
Prej syve të vjetër
Pikon gjak

Qanë për nipin
Ofshanë për mbesën
Me lot hidhërimi
E lan vesën

SA MË PARË

Pse ja ndale
Rrjedhën lumit
Dhe ja prishe
Ëndrrën gjumit

Mos u zgjo
Në këtë errësi
Dita bëhet
Shumë e pështirë

Fli gjumashe
Ëndërro dëborën
Sa më parë
Ta shohësh Kosovën

SA SHUMË FËMIJË

Shpeshherë natën
I del gjumi
Me duar të vogla
I fërkon sytë
Si është sonte
Kosova martire
A janë fëmijët
Atje me vajë

A kanë bukë
Për të ngrënë
A janë me familje
Athua kanë nënë

Ishte luftë
Në vendin tim
Sa shumë fëmijë
Mbetën jetim

JAM E VOGËL

Jam e vogël
S di të këndojë
Për ata që luftuan
Por unë kurrë
Nuk do ti harrojë
Trimat tanë
Që na çliruan

EVROPA E VJETËR

Tjetër ngjyrë
Këtu paskanë lulet
As aroma
Nuk është e njëjtë
Shiko barin
Si përkulet
Shiko lisat
Me krajatë

Përse mami
Është kështu
Të lutem më shpjego
A mund të jetojë
Unë këtu
Fol të lutem
Mos më mundo

Bija e mamit
Mendjeholla
Ngjyrën e kuqe
Nuk e ka molla
Çdo gjë këtu
Ka shije tjetër
Kësaj i thonë
Evropë e vjetër

MOS HARRO

Cicëron zogu
Në fluturim
Me mallë
Për në vendin tim

I përshëndet ata trima
Që nga goja
U del vetëtima
Që pinë ujë
Në atë burim
I përshëndet
Zanat e malit
Zogjët e fushave
Në ëndrrat e djalit

Edhe djemtë e UÇK-ës
Që i lanë eshtrat
Në zemër të malit
E përshëndet
Gjithë Shqipërinë
Mos harro
Pash perëndinë.

VENDI ME LISA

Eci udhës
Zdirgjem malit
Në degë këndon
Një zog rebel
Plotë mallëngjim
Si vaji i djalit
Që u tretë
Në zabel

Nuk ishte theporja
Vend me lisa
Po i qëndisur
Me beton
Atje larg
Ku s' takon plisa
Djali i lagjes
Tonë banon

LETËR NGA MËRGIMI

Isha i mërzhitur o gjysh
Nuk dija çka të bëjë tjetër
Nga mallëngjimi dënosa si klysh
Loti më pikoi në letër

Si janë punët atje në Jug
A po nxeheni në diellin e lirisë
A po keni enë e lugë
Në atë tokë gratçore të Shqipërisë

A i ke ruajtur lodrat e mia
Që me aq mund i pate blerë
Kur unë qaja mu si fëmija
S'kishim dritë jetonim në terr

Tani fërfëritin flamujt e lirisë
Çdo dëshirë në jetë dyzohet
Ata që e sjellën këtë ngadhënjim
Emri i tyre kurrë nuk harrohet

CELULARI

Celulari i gjyshes
Cingëroi në bagazh
Genti kishte dërguar
Më të mirën mesazh

Urime ditëlindja
Për shumë vite gëzuar
Urime Urime
Qofsh e lumturuar

NËNAT TONA

Alo gjyshi a je mirë
Si është koha në Kosovë
Për herë të parë të telefonojë
Si i keni hallet na trego
A keni për diçka nevojë

Sot është ditëlindja e ime
Unë u lindi në Prishtinë
Ku jetonim me thërime
Të kujtohet gjyshi im

Ishte atëherë koha e lig
Kur të huajt na sundonin
Nënat tona i quanin shtrigë
Kurse të vetat i bekonin

Ti or gjysh mos u merakos
Të gjithë ne kemi një dëshirë
Vetëm një brengë na mundon
Që te ju të bëhet mirë

TE ARIU

Fli moj ezmere
Mos ke frikë
Nesër do lindi
Dita e re
Do të shkojë
Me Gentin
Në zoologjik
Edhe ti
Vjen me ne

Të kujtohet “te Ariu “
Se si qeshte
Majmuni në kafaz
Kurse GENTI
Me aparat
Fotografonte
Në fërfëllizë

Atje do lozim
Deri në agim
Do ta mashtrojmë
Skilen plakë
Fli ezmere
Gjumashja e gjyshit
Gjumi të bënë
Shtatëbajrak

NË PRISHTINË

I dashuri Genti o vëlla
Shumë ëndërrojmë ne në Ottavë
Për fushat e gjëra të Kosovës
Që janë të mbuluara me bar

Përse hesht dhe je i mërrrolur
Athua largësia po të ligëshon
Apo mallëngjimi të ka lodhur
Dhe në heshtje po mejton

Fol se plasa nga kjo mynxyrë
Do të tretim si qiri në errësirë
Tregomë i dashuri vëlla
Si është tani në Kosovën e lirë

Në Prishtinë lulet çelin
Mu si zogjtë kur këndojnë
Shumë më afër e kanë diellin
Në reze të arta atje notojnë

KUR FLET ERA

Ka sa kohë
E disa muaj
Era flet
Një gjuhë të huaj

Ajo nuk di
Të flasë shqip
Eh kjo punë
Qenka pa kripë

Lulja e saj
Në dritare
I mësoi germat
Në abetare

PRANVERA NË KOSOVË

Buzë Lumëbardhit
Në shatërvan
Po këndon
Një zog i gëzuar
Se pranvera në Kosovë
Sivjet më herët
Paska filluar

Në këtë stinë
Kthehen dallëndyshet
Edhe shumë
Zogj shtegtarë
Kthehu edhe ti me ta
Të pret baba
Me behar

NË DHE TË HUAJ

Tungjatjeta o fusha
Heu mirëdita ju o male
Nga Kanadaja dërgon
Përshëndetje një sorkadhe

Shoqet punët si i kanë
Mësimet si u shkojnë
A lozin me kukulla
Apo libra lexojnë

Këtu në mërgim
Shumë pak shoqe kam
Dhe tejet e vetmuar
Në dhe të huaj jam

VETMIA

Xhaxhi Mendi po venitem
Këtu në dhe të huaj
Si qiriu i Naimit
O të lutem babit i thuaj
Të na largoj prej mërgimit

Këtu buka s' po na hahet
As ujë nuk mund të pimë
Këtu dielli në lumë nuk lahet
Si qyqe mali ne po rrijmë

Thuaj xhaxhi mos harro
Lute të na kthej në Kosovë
O të përgjërojë insisto
Se po venitemi si lulja në dëborë

EDHE UNË

Edhe unë kam
Një dashuri
Që jeton në mërgim
Vogëlushja Adea
Shtatëselvi
Ajo është
Gëzimi im

Me te zgjohem
E bie në gjumë

Vetëm një brengë
Më mundon
Se nuk ka kush
Në atë vetmi
Përralla të bukura
Që i tregon

GJYSHI PRIT

Jam i lodhur
Dhe i sfilitur
Letër nga Genti
Duke pritur

Në fund fati
Qeshi si fëmijë
Erdhi letra
Me porosi

Gjyshi na prit
Në aerodrom
Se nesër kthehemi
Me avion

FLOK THINJAK

Rinte ulur
Mbi trung të qershisë
Me sy të përlotur
E sodiste largësinë
Ai nuk di
Kah i bie Jugu
Ku e ka shtëpinë

Në dhe të huaja
Ishte tretur
Fëmijërinë pa e gëzuar
Kalamendej pa shpresë
Bredhte duke ecur
Njeriu me zemër
Të lënduar

Ecte bredhte
Një plakush
Flokë thinjak
Si arushë

URDHËRESA

Gjyshja e mbesa
Si lulja dhe vesa
Të dyja lozin
Në një sokak
Në celular
Tingëllon urdhëresa
Ndaleni lojën
Pushoni pak

Mesazhi i çuditshëm
Nga Marsi zbret
Dhe kishte vetëm
Një porosi
Ndaleni lojën
Pushoni pak
Sepse fëmijët
Sot protestojnë
Kundër dhunës
Që të rriturit ushtrojnë

TË FALA KOSOVËS

Kaçurrela e vogël
Kishte mësuar vet
Me e thirr gjyshin
Në internet

Ka shtypur butonin
Dhe bisedon
Si një zogëz
Kur ligjëron

Të fala Kosovës
Me shumë uratë
Në tela dëgjohet
Zëri i saj çdo natë

TË FALA DJEMËVE

Nga po vjen
Moj dallëndyshe
Athua ishe në mërgim
Tregom sa dete
I kalove
Deri sa erdhe
Në Prishtinë

A i ke parë
Nipat dhe mbesat
Udhëve të botës
Duke shëtitur
Ose i takoje
Në stacione
Trenin e fundit
Duke pritur

Fluturo or zogë
Shtegtarë
Sa më parë
Në perëndim
U çon të fala
Djemve tanë
Se presim
Me padurim

PLAKU I LODHUR

Ndalun pak
Ti or plak
Përse këto vargje
Kullojnë gjak

Për çfarë
Zemra të loton
Pse në qepalle
Vaji qëndron

Edhe unë farefisim
E kam në mërgim
Por nuk lodhem
Me këtë vegim

LETRA

Në krah të erës
Letra e shkruar
Po udhëton
Pa pritesë
Dete e male
Duke i kaluar
Po kërkon
Një adresë

Djalin e tretur
E lyp baba
Letrën e shkroi
Me mallëngjim
Kthehu bir
Në shtëpi
Flakë po digjet
Shpirti im

TË LOZIM FUSHAVE

Shpeshherë me lot
Më mbushet gusha
Kur s vrapojë
Nëpër fusha

Kështu është
Në perëndim
Më beso
O gjysh i im

Shumë të drejta
Kemi në letër
Por na duhet
Diçka tjetër

Të lozim fushave
Sikur era
Të vrapojmë maleve
Kur del pranvera

KUR NGA DHEMBJA

Aty ku është zemra
Gurgullon një lumë
Ai i trishtimit
Që më lenë pa gjumë

Vjen e i vërshon ëndrrat
Degdiset si përherë
Por më së shpeshti
Gufon në pranverë

Gjarpëron ecën lumi
Nëpër qenien time
Shpeshherë ikën larg
Dhe kthehet me vegime

Kështu për çdo stinë
Në vjeshtë apo në dimër
Vezullojnë lumenjtë e shpresës
Kur nga dhembja thyhet një zemër

E THEN GURIN

Më besoni
Të dashur fëmijë
Nuk qaj unë
Kaq lehtë
Por kësaj radhe
Syri loton vetë

Loti i hidhur
E thyen gurin
Andaj ligështon
Edhe burrin

Dënesi me mall
Dhe hidhërim
Se i kam dy sy
Në mërgim

A KA BABI ADRESË

Mami a ka babi adresë
A di ku banon
Pse asnjë letër e shkruar
Te ai nuk po shkon

Shokët e klasës
Me mua po qeshin
Lloj lloj epitetesh
Pas shpine ma veshin

Përse hesht mami
Pse nuk më tregon
Ku e kam babin
Kjo po më mundon

Babi yt or bir
Është diku në mërgim
Pusho mos qaj zemër
Fli zogu im

PRITJA

Eshtrat i kam të sflitur
Më janë lodhur sytë
Trenat duke i pritur
Shpresat mu kanë mbytë

Për çudi binarët
Udhëtojnë në pafundësi
Duke i qarë hallet plaku
Me një mërgimtarë të ri

13 / 14.03.2007

Emrin e kam fjalë

FJALA

Nëse më kërkoni
Do të më gjeni kudo
Zbres nga lashtësia
Kam lindur moti
Dhe lindi me ju

Përzihem me lodrat e juaja
Ju shoqërojë në lojë
Vij nga nëntoka
Përrallave
Ua shtojë hijeshinë
Fëmijërisë lumturinë

Rritem në praninë tuaj
Me mua mbroheni
Ndonjëherë më keqpërdorni
Duke u grindur me shokët
Si në shtëpi
Hy në ëndrrat e juaja
Dhe sërish zhdukem
Si hija e thyer
Unë jam kudo
Në qytet dhe në mal
Emrin e kam fjalë

THUAJ EMRIN TIM

Kam lindur
Nga një tokë e vjetër
Lashtësinë time
Mos e kërkoni në përralla
Ndoshta i kam
Pesë mijë vjet
As vet nuk e di
Ditëlindjen

Mund të më kërkosh
Në tregimet
E popujve të vjetër
Ose nëpër legjenda
Që madhërojnë
Jetën e heronjve
Kurse ndonjëherë
Jam krejtësisht e re
Në disa vende
Ende nuk kam lindur

Jetojë në zemrat e ndrydhura
Të popujve të përvuajtur
Jetojë në krahët e zogjve
Të mbyllur në kafaz

Ende pa lindur
Sa ëmbël jetojë

Thuaj emrin tim
KE MUNDËSI

Ke mundësi
Që ta mësosh qenin
Të paraqitet në telefon

T' ua mësosh gjuhën
Zogjve në fluturim
Ose lumit të dalldisur
Me ja ndërrua kahjen
Por kurrë nuk mundesh
Ti udhërosh kokës
Që të mos fantazojë

Shiko po të them
Ti mundesh vogëlush
Ti kalerosh yllësit
Detin ta fusësh
Në një gotë të vockël
Por mos harro
Se kurrë nuk mundesh
Të urdhërosh zemrën
Të mos galdojë për dashuri

LULE NË KARNEVAL

Koka më sillet vërdallë
Gjumi nuk me zënë
Si në ndonjë përrallë
Ëndrra zien e s' vjen

Në ujëra të turbullta noton
Sa që peshqit xhelozojnë
Herë herë qiellit fluturon
Shqiponjat të lakmojnë

Tani je një gjeneral
Që edhe bletëve u komandon
Më vonë lule në karnaval
Ëndrra kudo të çon

SYTË

Fjalë më të bukura
Flasin sytë
Shpeshherë në heshtje
Bisedojnë
I njohin gjërat për mrekulli
Gënjeshтарin e dallojnë

Sytë shohin rrezikun
Armikun e përcaktojnë
Sytë shohin vashëzën
Sytë dashurojnë

Dy xhevahire
Nuk ngopen me dashuri
Ato nuk mashtrohen
Me asnjë mirësi

Në sy rritet loti
Si në qiell shiu
Në sy lind dashuria
Me sy qesh njeriu

GJUMI

Vjen në krahët e natës
Për ta sjell qetësinë
Largohet me agimin
Ta dhuron mirësinë

T'i largojë krajjat
Mosmarrëveshjet i hedh në lumë
Të përkund në djepin e ëndrrave
Se mua më thonë gjumë

Kur je i shqetësuar
Mbi sytë e tua flejë
Sepse jam betuar
Mos të të hidhëroj

Jam më i forti në botë
Me mua s' bëhet shaka
Por vetëm ti kur ëndërron
Unë s' kam çka të bëj

PËRRALLË

Unë nuk di
Ku i merr gjyshi fjalët
Për ato përralla të bukura

Mos vallë
Ai plakush thinjosh
Ka ndonjë thes të lashtë
Nga i cili nxjerrë
Për çdo ditë
Nga një përrallë me kashtë
Apo tregim
Ku rrëfohen krajjat
E vendit tim

Përralla të harruara
Të përziëra me mite
Rrëfime të moçme
Përjetime ilire
Na tregon gjyshi
Për merak
Plaku bujar thinjak

KU GJINDEN FJALËT

Tunde kokën pak
Gjeje një fjalë
Hidhe në letër
Të bëhet mal

Kështu shkruhet tregimi
Me fjalë e fjalitë
Ti vetëm sprovo
Ke për t'ja arrit

E njoh kokën tënde
Je tejet i zgjuar
Veç ty të duhet
Njëherë për të provuar

MOS U LAKO KURRË

Mos rri i heshtur
Ngrite kokën pak
Atdheu nuk do
Asnjë frikacak

Thuaj babit jo
Kur ke të drejtë
Kështu çdo trim
Vepron në jetë

Fjalën e dhënë
Mbaje si burrë
Qëndro si lisi
Mos u lako kurrë

Fli me librin
Zgjoju me diturinë
Hapi mirë sytë
Lulëzoje shtëpinë

GJYSHI THINJAK

Gjysh i dashur
O burrë thinjak
Puna jote
Për merak

Unë të pashë
Në ëndërr mbrëmë
Se po ecje
Në tri këmbë

Një prej druri
Sa qesharak
Ti ecje me krenari
Duke u lëkundur pak

Pleqëria
Sa kënaqësi
Këtë e di
Çdo fëmijë

SA BEGATI

Gjysh e gjyshe
Sa begati
Nip e mbesë
Notojnë në gjithësi

Njohin vendin
Si bleta lulen
Para tyre
Të gjithë përkulen

Ata din përralla
Dhe tregime
Din shumë vjersha
Lozalime

Mësojnë legjenda
Dhe histori
E njohin atdheun
Për mrekulli

KURRË NË JETË

Kush hyn në lojë
Pa përvojë
Ai mbetet
Me gishta në gojë

E humb garën
I zbehet fytyra
Para tij
Turpërohet pasqyra

Kurrë në jetë
Mos u ngut
Nëse nuk ke në dorë
Një adut

QENI ILIR

Ky babagjan s' kënaqet
Me lajkat e huaja
As të huajin
Nuk e duron

Qëndron i uritur
Gjaku i gufon
Ushqimin nga i panjohuri
Kurrë s' e pranon

Ky qen i dashur
Miku im besnik
Vetëm anëtarët e familjes
I mban për mik

MËSUESI

Dashuroi lulet
I mbjelli fushat
Me ngjyra
Më të bukura

Dashuroi vendin
I ripërtëri kodrinat
Me lisa
Më të gjatë

Dashuroi abetaren
I gdhendi shkronjat
Në zemrat e fëmijëve

SOT

Jam i dashuruar
Deri në paskaj
Si ty dhe mamin
E dua Shqipërinë pa vaj

Sa fortë më ngazëllejnë malet
Dhe gjethet kur shushurin
Sa fort i dua lumenjtë
N' fusha kur degët i shtrinë

Ky vend mi lindi të parët
Që shkrepat i patën konak
Dhe këto male i rritën trimat
Që e mbrojtën me gjak

Thjeshtë tani mësova
Se dashuria trashëgohet
Nuk e dija e dashura mami
Se edhe atdheu dashurohet

Sot jam tejet i gëzuar
Po qeshi nga lumturimi
Se kjo tokë arbërore
Udhëton kah shpëtimi

ZEMRA

Zemra ime
Plot dashuri
Ajo do
Çdo njeri

E do malin
Që lulëzon
Dhe bilbilin
Kur këndon

E do mësuesin
E do vendin
E do lojën
Dhe kuvendin

Ka dëshirë
Që çdo njeri
Të jetojë
Në lumturi

PUNA

Kur pat nevojë
Zbriti nga lisi
Historia e njeh mirë
Janë shkruar
Shumë tregime
Nëpër shkëmbejë
I ka lënë gjurmët

Vepra e tij
Vulë e pashlyer
Në lashtësi
Nga puna
Mësoi njerëzimi
Të jetoj në begati

LUFTA

Në gjëmën e saj
Flenë kuja
Në të dashurohen
Budallenjtë

Kudo që kalon
Pas saj mbetet hiri
Dhe vaji i fëmijëve

Era e keqe kundërmon
Në sytë e të sëmurëve
Udhën e ka të gjakosur
Nuk ndalet as në ferr

Disa kanë ideale të larta
Jetën nuk e kursejnë
Vdekja për ta është mjaltë

Ca e ndjekin
Për t'i shpëtuar krimeve
E një grumbull tjetër
Ai soji i ndytë i njerëzimit
Pasurohet
Në kurrizin e saj
E kur të gjithë këta
Lodhen për vdekje
Sërish shpëtimin

E kërkujnë në luftë
GJYSHI IM

Sa shumë i donte
Gjyshi fëmijët
Dhe këngët
Kur këndonte
Në lahutën e vjetër

Edhe kur takohej
Me vdekjen
Ai u këndonte fëmijëve
Për legjendën
E vashës me lule

Ai trim mbi trima
Kurrë nuk lejoi
Që t ja shëmtonin
Lulen në shkëmb

Plakushi i urtë
Përherë takohej
Me vdekjen
Dhe këngët e vjetra
Heu ndjesë pastë
Sa shumë i donte
Fëmijët dhe lulet

**ÇAMARROKU
I VOGËL**

ÇAMARRKOU I VOGËL

1

S' len gjë pa prekur
Nëpër shtëpi
Çamarroku i vogël
Bënë kërdi

2

Gabimet e bëra
Kurrë nuk i pranon
Fajtoje është motra
Kështu më lehtë kalon

3

Unë s'e preka lulen
Vazon nuk e theva
As gotën me qumësht
Përmbysë nuk e ktheva

4

Kështu për çdo ditë
Për ngjarjet pa lakmi
Genti nuk është fajtor
Ai asgjë nuk di

5

Pa prekur rubinetën
Uji rrodhi si lumi
Faji i mbetet mjeshtrit

E kishte zënë gjumi

6

Unë isha duke fjetur

Kur u thye xhami

Tek e fundi

Nuk është bërë nami

7

Një ditë të ngrohtë vere

Në kullosë e lëshoi lopën

Iku të lozte me shokë

Deri sa bagëtia kulloste

8

Në mbrëmje lopa humbi

Nuk u kthye në shtëpi

Kurse Gentit të frikësuar

I lotonin sytë inxhi

Laroshja s'gjendej dotë

Laroshja s'gjendej dot

Si hija ishte tretur

Djaloshi e kërkoi kot

Nëpër ferra duke u strukur

10

Dikur u kthye i gjakosur

Të gjithë e pritnin me padurim

Nëna klithi e merakosur

Ç'të gjeti kështu biri im

11

E kërkova laroshen
Edhe te lugjet e shkreta
Lopa kishte humbur
Askund nuk e gjeta

12

Të gjithë njëzëri qeshën
Me loçkën e hallës
Lara ishte kthyer
Përtypej në fund të stallës

13

Laroshes i pëlqen shumë
Ahengu dhe troku
Ajo nuk merakoset
Se çka bënë çarramoku

14

Djaloshi rrinte i heshtur
Ishte prekur shumë
Andaj vendosi si burrë
Të mos bëjë zullum

15

Që nga ajo ditë
Sjelljet i ndryshojë
Dhe u dallua nga shokët
Kur në shkollë shkojë

ËNDRRA E GENTIT

1

Genti ëndërron
Për çdo ditë
Sa më shumë
Për tu rritë

2

Kur të bëhet
Gjashtë vjeçar
Do ta vijojë
Klasën e parë

3

Në të dytën
Dhe tretën si prore
Do të dalë
Shembullore

4

Katërtën dhe pestën
Si për mahi
Do i përfundoj
Ky djalë i ri

5
Për gjashtën dhe shtatën
Nuk diskutojmë
Vetëm pesat
Do t'i numërojmë

6
Kur të del
Në klasën e tetë
E ndjen veten
Sikur mbret

7
Vijnë pushimet
Fillojnë hallet
Nuk di ku të
Çmallet

8
Shumë dëshira
I dalin përpara
Sikur lulet
Nëpër ara

9
Një dilemë
Ka pas përherë
Të bëhet mjek
Apo inxhinier

10
Të gjitha dëshirat
Si lumi rrjedhin
Në cilin drejtim
Hapat ti hedhim

11
Kështu ëndrra
Ditë e natë
E mundon
Pa lëshuar shtat

12
Fli o gjumash
Sa më shumë
Gjumi të rritë
Të bënë pëllumb

13
Koha vjen
Në shkollë do shkosh
Tok me shokët
Do ta gëzosh

14
Tani rritu
Fito përvojë
Atdheu për ty
Ka nevojë

SEMAFORI

1

U mblodhën disa shokë
Këndshëm biseduan
Pastaj një çetë
Për një garë formuan

2

Njëzëri votuan
Arbëri të jetë kryetar
Dhe më vonë kërkuan
Me konkurs një sekretar

3

Ile të jetë i urtë
I sjellshëm dhe i mirë
Shokë i gjithanshëm
Me përvojë zinxhir

4

Pra këto veti
Ne të gjithë i kemi
Duam që edhe ai të jetë
I shpejtë si zgalemi

5
Në gazetën e murit
Konkursi u shpall
Arritën kërkesat
Nga çdo mëhallë

6
Filloi komisioni
Lutjet t'i shqyrtoj
Dhe një nga një
Dorëshkrimet i lexoj

7
Propozojë Armendin
Tha një anëtarë
Është më i miri
Në klasën e parë

8
Tepër i sinqertë
Thanë me krenari
Neve si ai na duhet
Shtoi kryetari

9
I tërë komisioni
Ishte i mendimit
Ta pranojnë Mendin
Vëllaqkon e Ximit

10

Të nesërmen në mëngjes
Të gjithë u tubuan
Armendit dhe Arbërit
Detyrën ua uruan

11

Në foltore hipi i pari
Shokë ju falënderojë
Besimin e dhënë
Do ta arsyetojë

12

Prej më të mirëve
Do formojmë një çetë
Dhe do bëjmë gara
Me çdo qytet

13

Tema do të jetë
Mirësjellja në komunikacion
Dhe si të ecim rrugës
Kur automjeti kalon

14

Nxënësit më të mirë
S' do mbeten duarthatë
Të gjithë do të marrin
Nga një dhuratë

15

Por për hall e kemi
Të vetmin problem
Si ta emërojmë shoqatën
Mjaltë apo gjemë

16

Propozuan disa emra
Dritë Flakë Motor
Së fundi e pagëzuan
Thjeshtë Semafor

17

Si zgjoje bletësh
Shkolla po ushton
Sa bukur mësonin
Për komunikacion

18

Pas disa ditëve
Garat filluan
Prei të gjitha viseve
Fëmijët u tubuan

19

Pa pikë brengje ishin
Në këtë qytet magjik
Ku për disa ditë
S'do këtë matematikë

20

Shenjat e komunikacionit
Tema do të jetë
Dhe pastaj do dalim
Në provim me biçikletë

21

Në komision janë
Nxënësit shembullor
Që dallojnë prej tjerëve
Në rrugë dhe në shkollë

22

Na trego Zymber
Si e kalon semaforin
Edhe ti Skënder
Ç'bënë kur e ndez motorin

23

Shikojë djathtas
Kah kalon citroeni
Ose majtas
Simpatikun ami

24

Kur qesh syri i gjelbër
Pa frikë kalojë
Kështu përherë
Shenjat i respektojë

25

Kur e ndezi motorin
Ndjej një kënaqësi
Jam autist i mirë
Nderojë çdo përparësi

26

Në radhe është Shpendi
Astriti dhe Liza
Të na tregojnë
Përse shërben zebra

27

E ka trupin me lara
Dhe jeton në savanë
Përherë është e para
Si era vrapon

28

Si në kor
Të gjithë qeshën
Në përgjigjen e pasaktë
Që u dha për zebrën

29

Lizës i erdhi keq
Për shkak të pakujdesisë
Shpendi e kishte mendjen
Në orë të biologjisë

30

Ku nuk ka semafor
Aty zebra larcohet
Të kalojë nxënësi
Kur nga shkolla kthehet

31

Edhe për studentin
Ushtarin dhe fshatarin
Këtu është vendkalimi
Vetëm për këmbësorin

32

Edhe në pyetjet e tjera
Përgjigjet ishin të sakta
Sa mirë kishin mësuar
Këta çerata

33

Kishte shumë ekipe
Zebra autisti këmbësori
Por më e mira doli
Çeta semafori

34

Dhuratat më të mira
Ishin duartrokitjet
Për të palodhurit
Që i dhanë përgjigjet

35

Pastaj filluan lojërat
Kënga mori dheun
Këndonin për trimat
Që luftuan për atdheun

INSPEKTOR MASKA

Xërr telefoni
Xërr po cingëron
Inspektor maska
Në shtëpi s'qëllon

Ka do ditë
Një problem
E mundon
Axhën Xhemë

Një nxënës
I klasës dytë
Të gjitha muret
I ka zhytë

Inspektori
I hidhëruar
Ia mbërrin
Duke vrapuar

Aspak pa u vonuar
Erdhi si laraska
Zgjodhi problemin
Inspektor maska

TOMI DHE XHERI

Na ishin njëherë
Dy miq për çudi
Njëri quhej Tom
E tjetri Xheri

Donin njëri tjetrin
Bënin çudira
Tërë ditën
Orëve të lira

Lëshonin ujin
Prishnin rubinetë
Hidraulikun
Nuk e lënin të çetë

Një ditë hidrauliku
Shkoi te konstruktori
Dhe pastaj me vrap
Tek montatori

Ai montoi kurthin
Sikur rubineta
Për Tomin dhe Xnheri
Fare pa helmata

Të nesërmen pa gdhirë
U lëshuan në lojë
Qeshën dhe vrapuan
Fare pa nevojë

Më vonë vendosën
Të luajnë me rubinetë
Pa menduar fare
Se ç'do me i gjet

Po sa e prekën
Ajo i kurthoi
Uji më nuk rrodhi
Dhe filmi mbaroi

PROFESORI BALTAZAR

Profesori Baltazar
Bëhet mjek
Veterinar
Një ditë tjetër
Agronom
Apo të nesërmen
Astronom

Di të bëhet
Murator
Të punojë
Me eskavator
Me makinë bënë
Mrekulli
Shpik gjëra për bukuri

Dhe një ditë
Dy nxënës përtac
Vajtën te i miri Baltazar
Iu lutën pa u skuqur
Që tua përmirësojë
Njëshat në ditar

Por i urti Baltazar
U drejtua me këto fjalë

Notat s' falen ore çuna
Por duhet shumë ju të mësoni
Pastaj do vaj mirë puna
Pa u skuqur
Mëshirë të kërkoni

Sa mirë këshillat
I dëgjuan
Dy shok të mirë
Por përtac
Me shpejtësi në shtëpi shkuan
Dhe më kurrë
Nuk dalën në lojë
Deri sa njëshat i përmirësuan

SËRISH PËR BALTAZARIN

Të gjithë qytetarët
Në hall patën rënë
Prej maçokut ngucakeqit
S'dinin ç'të bëjnë

I fshihte fletoret
Çantën me abetare
Nxënësit në shkollë
Shkonin pa mësuar fare

Dhe ditët kalonin
Si lumi që rrjedh
Maçok trazovaçit
S'kish kush qafën
T'ia dredh

Një nxënësi iu kujtua
Profesori Baltazar
Dhe tha ai këtë problem
Do e zgjedh sa më parë

Dërguan një delegacion
Prej nxënësve të klasës parë
Që të këshillohen
Me të urtin Baltazar

Ai vrapoi nëpër dhomë
Mu si një robot
Dhe në fund bërtiti
Ky problem zgjidhet sot

Iu ofrua makinës
Mbushi një epruvetë
Bëri një qen të madh
Sa dëshirojë vetë

Me shpejtësi vetëtime
Laroshi shkoi në qytet
Dhe ndjeku maçokun
Deri në det

Fëmijët u gëzuan
Qeshën si behar
Tërë ditën kënduan
Baltazar Baltazar

Fli biro flij

Babi
A ka sy Qielli
E zemër Dielli

Athua toka ecën
Me këmbët e veta
Apo rrotullohet

Si ylzi
Ka më Galakësi
Të lutem babi
Më trego këtë fshehtësi

Dua të di
Ku flen toka
Dhe me çfarë jorgani
I mbulohet koka
Në cilin det
Duart i lanë
Në cilin lumë
Këmbët i shpërlan
Dhe me çfarë brushe
Dhëmbët i pastron

Lum babi
Më trego njëherë
Se gjumi në sy
S'më vjen si ka herë

Fli biro fli
Tani është natë
Qielli sytë
I ka mbyllë
Në zemrën e diellit
Rritet një bylbyl

Tani je i vogël
Kur të rritesh
Do bëhesh astronaut
Atëherë i njehson yjzit
Në çdo skutë

Fli biro fli
Toka flen
Në mirësinë tënde
Mbulohet me
Ëndrrat e fëmijëve
Duart i lanë

Me qeshjet e vogëlushëve
Këmbët i shpërlan
Me gëzimin e fëmijëve
Dhëmbët i pastron
Me lojën e fluturave
Fli biro fli

1978, nr.10 "Fatosi"

Ku e ka Dielli vendlindjen

Shpeshëherë pyet një voglush
Për vendlindjen e diellit
Për atë sy të zjarrtë
Që si kali i erës
Endet Qiellit.

Pyet për Hënën
Arushën e madhe
Dhe për yjzit e tjerë
Që vrapojnë si surkadhe

Prej pyetjes në pyetje
Vogëlushi gjezdis
Kush e mban Tokën
Lum babi
Që nuk lëviz

Çfarë han Dielli
Banane apo çokollatë
Ku pi ujë Hëna
Kur bëhet natë

Me çfarë nxehet Dielli
Kur errësohet Qielli
Ç'përdor për nxemje
Stufë apo kalorifer

Lum miku më trego
Ku e ka vendlindjen
Ai sy magjik
Më trego
Më trego
O mik i dashur
Kur ecën Dielli
A mëson matematikë

1978, nr.12 "Fatosi"

Hëna ka blerë një abetare

Për çdo natë
Në dritare
Lexon Hëna
Në abetare

Alfabeti
E çon gjithnjë
Prej yllit polar
Deri në veri

Pastaj vazhdon
Në Amerikë
Për të mbri
Në Antartik

Andaj nënës
Gëzohet Toka
Kur kalon Hëna
Kah Evropa

Nëpër Afrikë
Dhe në Azi
Kjo punëtore
Bën mrekulli

Mijëra shkronja
Vallëzojnë kah Qielli
E shenjat e pikësimit
Shëndërrisin si Dielli

Kur ta mësojë
Tërë alfabetin
Do t'u shkruaj
Fëmijëve një letër

Përmbajtja e letrës
S'dihet fare
Deri sa Hëna
I mëson gërmat në abetare.

SHËNIME PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha lindi në Prizren me 1943. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë.

Një kohë punoi si mësues nëpër fshatra: Studenqan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Enregjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha fëmijërore. Rugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revisten: “PIONERI”, me 1957.

Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës formoi grupin letrar: “Lulëkuqet e Kosovës”. Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja: “Ngjyra e kohës”, në të cilën u botua një numër i poezive të tij. Veç krijimeve që i publikoi në revistat për fëmijë botoi edhe nëpër gazetatat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës.

Veprimtaria letrare u pasurua me shumë tituj që deri më tani ka të botuar këto libra:

“**Puthjet**”- poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1974

“**Ecjet e viteve të mëdha**”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.

“**Çamaroket e thepores**”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.

“**Muret**”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997

“**Morfologjia e dhembjes**”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë 2000.

“**Ai vjen nesër**”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu, Kastriot, 2007

Ky është libri i shtatë i tij. Jeton në Prishtinë ndërsa aktivitetin letrar e zhvillon në Klubin letrar: “Fahri Fazliu” në Kastriot.

ADEM ZAPLLUZHA
Letër nga mërgimi

Radhitja kompjuterike
Autori

Realizimi kompjuterik
“OBSCURE”
Prishtinë

U shtyp në shtypshkronjën
“TREND”
Prishtinë, 2007